

NJOFTIM PËR SHTYP

MBI VERIFIKIMIN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE QË KANË SHPREHUR INTERES PËR TË QENË ANËTARË NË KOMISIONIN E SHOQËRISË CIVILE QË DO TË KRYEJNË VERIFIKIMIN PARAPRAK TË KANDIDATURAVE PËR ANËTARIN QË PËRFAQËSON SHOQËRINË CIVILE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË

Me përfundimin e afatit të shprehjes së interesit nga Organizatat e Shoqërisë Civile, afat i cili ishte përcaktuar deri më datë 8 shtator 2023, Avokati i Popullit nisi përsëri procesin e verifikimit të plotësimin të kriterëve nga Organizatat që kishin shprehur interes për të qenë pjesë e komisionit të shoqërisë civile duke bërë publike emrat e organizatave të cilat plotësonin kriteret e përcaktuara ligjore.

Sic kemi informuar dhe më parë, organizatat e shoqërisë civile që kishin paraqitur shprehjen e interesit në thirrjet e mëparshme dhe kishin përmbushur kriteret e përcaktuara ligjore, nuk paraqitën shprehje tjetër interesi pasi kandidatura e tyre u konsiderua e vlefshme për fazën tjetër të procesit.

Organizatat e Shoqërisë civile të cilët, pas rishpalljes së fundit, shprehen interes për të qenë pjesë e komisionit të shoqërisë civile, janë si më poshtë:

- ✓ Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm
- ✓ Qendra për Çështjet e Informimit Publik “Infoçip”
- ✓ Shoqata “Drejtësia Sociale”
- ✓ Klinika Ligjore “Wisdom”

Në përputhje me pikën 1, të nenit 54 dhe pikën 1, të nenit 152 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, procesi i verifikimit u bazua në tre kriteret e mëposhtme:

- ✓ Regjistrimi sipas legjislacionit përkatës;
- ✓ Të punuarit në fushën e sistemit të drejtësisë ose të të drejtave të njeriut, dhe
- ✓ Të kenë zbatuar projekte në këtë fushë të paktën pesë vitet e fundit.

Pas përfundimit të këtij procesi verifikimi, Avokati i Popullit njofton se organizatat e shoqërisë civile të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore për të vazhduar në fazën tjetër të procesit janë si më poshtë:

- ✓ Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë
- ✓ Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim"
- ✓ Qendra “Qëndresa Qytetare”
- ✓ Fondacioni “Kontribut për Edukim”
- ✓ Qendra Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm
- ✓ Qendra për Çështjet e Informimit Publik “Infoçip”
- ✓ Shoqata “Drejtësia Sociale”

✓ Klinika Ligjore “Wisdom”

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, neni 56 pikat 11 e 12 dhe neni 154 pikat 11 e 12, duke qenë se janë më shumë se 5 organizata që plotësojnë kriteret ligjore për të qenë pjesë e komisionit të shoqërisë civile, në mbledhjen e parë të këtij komisioni, e cila do të zhvillohet më datë 18.09.2023, ora 11.00, pranë institucionit të Avokatit të Popullit, do të përzgjidhen me votim të fshehtë organizatat që do jenë anëtarë të tij, si dhe anëtari zëvendësues. Pesë organizatat që do marrin më shume vota, do të konsiderohen të përzgjedhura si anëtarë të komisionit të shoqërisë civile.

Tiranë, më 15.09.2023